

# Bota e pasur shpirtërore e njerëzve të luftës

Agim Faja

Një ndër ato të shumta tablo të Ekspozitës kombëtare të 30-vjetorit të Çlirimit, që të fut në mendime, «të heq për mënge të xhakëtës e të thotë: «qëndro dhe shikomë se do të mësosh diçka», është edhe kompozimi «Për ata që i kënduan luftës», i piktorit Andon Lakuriqi.

Gjatë tërë krijimtarisë së tij të deritanishme autori ka trajtuar me dashuri dhe frymëzim disa herë temën e Luftës. Emocione dhe mendime na kanë ngjallur veprat «Pas luftës» e «Fundi i fashistëve». Në tablotë që trajtojnë këtë temë, vihet re pasqyrimi i madhështisë së luftës sonë, epikës së saj, evidentimi i vlerave dhe tipareve pozitive të personalitetit dhe karakterit të partizanëve tanë, bota e madhe shpirtërore e tyre.

«Për ata që i kënduan luftës» shtjellon një moment tepër interesant, modest, por domethënës. Partizanët dhe fshatarët, të ngjitur aty mbi fshat, janë ulur e po dëgjojnë një këngë për luftën, për dëshmorët e saj. E këndon këtë një djalosh i vogël, një nga ata që mbushën radhët e partizanëve, (e jo më kot duke e parë këtë sjellin ndërmend Met Hasën e Çelo Sinanin, Lica Pinën e Kujtim Rulin etj., gjithë ata vogëlushë që kanë kopetë e shkuan maleve pas baballarëve, vëllezërve e motrave të tyre), dhe e shoqëron me violinë një trim nga ata të malit. Në këtë peisazh të ashpër, si vetë jeta

e shqiptarëve, shpërndahen tingujt melodiozë të këngës.

Zgjidhja kompozicionale në formë rrethi të hapur, me një zhvillim qendror, ulja e të gjithëve rreth e qark si pranë një zjarri partizan (e pse jo, kur edhe kënga është zjarr), si pranë vatrës (gjithnjë shqiptari kështu është ulur pranë vatrës, në formë rrethi, këtu autori ruan dhe një theks të njohur kombëtar), e ka ndihmuar për të vënë në pah më shumë mendimin, e ka bërë tablonë më bindëse, më të vërtetë, më shqiptare.

Tablonë e përshkon një dinamikë e brendshme; një pothos epikolirrik. Duke pasqyruar këtë episod, piktori ka fiksuar edhe qëndrimin e tij estetik, ka futur ndjenjat dhe emocionet e veta, mendimet që i ka ngjallur ky realitet.

Realizimi i drejtë i detajeve, jo formalisht, por me një synim të caktuar, ka bërë që tabloja të jetë emocionante dhe jetësore, të arrijë domosdo në një përgjithësim të fortë artistik. Kështu, janë dhënë me dashuri partizanët, secili në qëndrimin e tij të thjeshtë e pa pompozitet, këmbëkryq me popullin; po kështu, shumë të gjetur janë dy fshatarët dhe gratë që dëgjojnë me vëmendje tingujt e këngës. Ka secili reagimin e vet ndaj kësaj kënge të bukur, ka mendimet e veta që i ngjall kjo këngë.

Veç djaloshtit që këndon, i armatosur me fishekë e me granata,

një djalë tjetër simpatik e tipik fshatar, figurë interesante, është edhe violinisti. Me mjeshtëri violina është futur këtu si një personazh. Është një nga ato violina që kanë mbetur të heshtura nëpër muzeumet tona, e si cicërcimë flasin me heshtjen e tyre për bëmat e partizanëve, për udhët e luftës, bashkëudhëtarë të të cilëve qenë dhe ato. Ajo simbolizon këtu kulturën, ashtu sikurse dhe ai që i bie është prototipi i tërë atyre normalistëve që lanë bangat e shkollës e dolën malit për liri. Këzë e shohim jo vetëm në qëndrimin e tij prej shkollari, por edhe në mënyrën e vendosjes së gishtërinjve e të kapjes së harkut dhe të interpretimit që i bën këngës. Me mendim është ngërthyer finesa e kësaj vegle me pajimet e luftës. gjerdanin me fishekë dhe revolverin. Si mbyllën ato sallave mbretërore e «odave me qelqe» për të kënaqur pseudointelektualët e princeshat, që «... zbutnin turantë me krem parizian «Margaret», por shoqëruan gërxheve e maleve, në tym e flakë këngët «Malet me blerim mbuluar», «Basnkohuni shokë, me ne në çetë», «Lule Sofc lule djale» etj. Interpretuan edhe skerco të Paganinit, të Bahut e të Moxarit, dhe partizanët i thithnin më shumë se i dëgjojnë, madje edhe fshatarët, se gjithnjë populli ynë ka patur një borë të pasur shpirtërore, ka patur shpirt-artisti, ka ngritur në shekuj këngë shumë të bukura, megjithëse si ka njohur notat, e s'ka ditur të vejë në pentagrame.

Mendojmë se tabloja, megjithë vlerat ideoartistike, dëmtohet disi nga një coptim në trajtimin koloristik. Shpërndarja pjesë-pjesë e pikturimit të tërheq vëmendjen dhe të largon në një farë mënyre nga ideja qendrore e kompozimit, por kjo e metë nuk e çmon shumë ngrohtësinë dhe vërtetë.

(vijon në f. 13)



Andon Lakuriqi: Për ata që i kënduan luftës (vaj).

## NE FRONTIN E PUNES KRIJUESE

### Skenarë për filma

#### artistikë

Mbas skenarit të filmit «Në fillim të verës», që e merr temën nga Lufta Nacionalçlirimtare, puna për xhirimin e të cilit ka nisur, skenaristi Peçi Dado ka filluar punën për një skenar të ri. Skenari do të trajtojë e të pasqyrojë figurën e komunistëve në një aspekt mjaft të rëndësishëm të veprimtarisë së tyre gjatë Luftës Nacionalçlirimtare - në zbulim.

Për realizimin e tij ai po bashkëpunon me punonjës të tjerë të Kinostudios.

### Në skenë dhe

#### në ekran

Regjisori Dhimitër Anagnosti po vazhdon punën për xhirimin e kinovarietesë «Maskat», ku marrin pjesë aktorë të trupës së Estradës profesioniste të Tiranës. Në këtë kinovariete aktori Skënder Sallaku, Artist i Popullit, interpreton në disa skeçe, si p.sh. në skecin «Kërkohet një malarik», «Demokraci në familje» etj. Përveç pjesëmarrjes në filmin «Maskat», ai merr pjesë edhe në premierën e estradës së Tiranës me titull «Një pyetje nga salla», ku gjithashtu interpreton në disa skeçe, si p.sh. në skecin «Qarkullimi» të D. Bubanit në rolin e burokratit, në rolin e dembelit tek skeçi «Të heshturit» i Sh. Mitës, në rolin e servilit tek «Tre aktet e Salikos» të K. Devoles etj.

Në këtë premierë interpreton edhe aktörja Melpomeni Çobani, Artiste e Popullit, në role të ndryshme në skeçet «Kusht i vështirë» e «Qarkullimi» të D. Bubanit etj.

### Kompozim

#### për mbrojtjen dhe

#### portrete punëtorësh

Në bisedë me skulptorin Thanas Papa korrespondenti ynë mësoi se ai është duke punuar kohët e fundit rreth një vepre kushtuar mbrojtjes së Atdheut. Këtë kompozim autori ka ndërmend ta ekzekutojë në material të fortë, në gur. Në planet e tjera krijuese të tij përfshihen edhe disa studime rreth një kompozimi me temë nga traditat luftarake e patriotike të popullit tonë. Gjithashtu, ai mendon të punojë disa portrete të njerëzve të ditëve tona, veçanërisht portrete punëtorësh.

Korresp i «Dritës»